

## TRANSFERIMET, NJOHJA E KREDITEVE DHE EKUIVALENTIMI I LËNDËVE

### Transferimi i studimeve dhe dokumentacioni

Procedurat për transferimin e studimeve fillojnë me paraqitjen nga i interesuari, të kërkesës për transferim në sekretarinë mësimore dhe dokumentacionin e nevojshëm, i cili përbëhet nga:

- a. *Kerkesa me shkrim* e te interesuarit
- b. *Dokument identifikimi* (kartë identiteti ose pasaportë) si dhe *2 fotografi* në format pasaporte;
- c. *Karta e studentit* ose çdo dokument tjetër i cili vërteton që i interesuari gëzon statusin e studentit në universitetin nga i cili kërkon të transferohet;
- d. *Vërtetim* në lidhje me programin e studimit, vitet akademike të kryera dhe vitin akademik në të cilin ka ndërprerë studimet;
- e. *Listën e krediteve dhe notat* për secilën prej lëndëve të kaluara nga studenti (format zyrtar i lëshuar nga institucioni ku vazhdon aktualisht studimet aplikanti, me vulë dhe firmë);
- f. *Planin e plotë mësimor* për atë program mësimor nga i cili kërkon transferimin dhe *programet e lëndëve* që ka shlyer (formate zyrtare të lëshuara nga institucioni ku vazhdon aktualisht studimet aplikanti, me vulë dhe firmë);
- g. *Dëftesa e shkollës së mesme* dhe *Dokumentin/ Çertifikata* që vërteton kalimin me sukses të Provimeve të maturës (origjinale + fotokopje e noterizuar)

Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit dokumentat e mësipërme duhet të jenë origjinale së bashku me një kopje të dokumentave të përkthyer, të noterizuara në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Dokumentacion tjetër plotësues:

Formulari i aplikimit (i cili plotësohet në POLIS)

Vetdeklarata noteriale, ku të specifikohet dokumentacioni i dorëzuar në U\_POLIS, përgjegjësia e studentit në lidhje me autenticitetin e këtij dokumentacioni të dorëzuar dhe që studenti nuk është i regjistruar në asnjë universitet tjetër.

Tarifa e Aplikimit/Regjistrimit prej 5000 ALL (ose 37 Euro) që paguhet vetëm një herë në momentin e regjistrimit në POLIS)

Mandat pagesa nga banka e Tarifës Semestrare

Për studentët e transferuar në Programe Studimi me Kohë të Plotë nevojitet edhe Aplikimi në Zyren e Emigracionit për Leje Qëndrimi.